



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

Ekstrakt i Procesverbalit

të mbledhjes së katërt të Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 13.07.2017,
e cila filloi në orën 15:00.

Në mbledhje morën pjesë: Halim Halimi, kryesues i Komitetit, Dardan Sejdiu, nënkryetar i Komunës, Agim Gashi, shef i GP të LDK-së, Hazir Borovci, përfaqësues i LDK-së, Besa Rafuna, përfaqësuese e LDK-së, Lirak Çelaj, shef i GP të PDK-së, Laura Zherka, përfaqësuese e PDK-së, Hatixhe Hoxha, përfaqësuese e LVV-së, Mirlinda Sopi, shefe e GP të AKR-së.

Munguan: Brahim Mehmetaj, shef i GP të AAK-së, Qëndron Kastrati, shef i GP të LVV-së, dhe Cuneyd Ustaibo, përfaqësues i subjektit politik KDTP.

Të pranishëm ishin edhe: Agim Salihu, asistent i kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Ardian Olluri, shef i Zyrës ligjore, Besart Vllahinja, drejtor i Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Arben Vitia, drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Mustafë Neziri, zyrtar i Zyrës komunale për kthime dhe Osman Bllaca.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi **Halim Halimi**, kryesues.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së tretë të Komitetit për Politikë dhe Financa;
2. Plani komunal i veprimit për të zhvendosurit dhe zgjidhje të qëndrueshme;
3. Propozimvendimi për dhënien e pronës së paluajtshme komunale në shfrytëzim afatgjatë ndërmarrjes publike komunale “Hortikultura”;
4. Propozimvendimi për dhënien e pronës së paluajtshme komunale në shfrytëzim afatgjatë Fondacionit “Vier Pfoten”;
5. Propozimvendimi për dhënien e pronës së paluajtshme komunale në shfrytëzim Kompanisë Kosovare për Distribim dhe Furnizim me Energji Elektrike (parcela 285-0);
6. Propozimvendimi për dhënien e pronës së paluajtshme komunale në shfrytëzim afatgjatë Ambasadës së Republikës së Shqipërisë;

7. Propozimvendimi për bashkimin e blloqeve F-6, F-16, F-17 në kuadër të Planit rregullues urban "Prishtina e re - Perëndim";
8. Propozimvendimi për ndërrimin e destinimit të bllokut "C-5", në kuadër të Planit rregullues urban "Medrese - Çamëri";
9. Propozimvendimi për ndërrimin e destinimit të parcelës 494-4, në kuadër të Planit rregullues urban "Prishtina e re - Perëndim";
10. Propozimvendimi për dhënien e pronës së paluajtshme komunale në shfrytëzim Kompanisë Kosovare për Distributim dhe Furnizim me Energji Elektrike (afatshkurtër);
11. Propozimvendimi për dërgimin e Rregullores për të hyrat vetanake të institucioneve kulturore vartëse të Komunës së Prishtinës, në konsulta paraprake publike;
12. Propozimvendimi për dhënien e pronës së paluajtshme komunale në shfrytëzim afatgjatë - fushat e tenisit;
13. Raporti për sigurinë në shkolla;
14. Diskutim për projektin e xhamisë së madhe në Prishtinë;
15. Të ndryshme.

Para se të fillonin diskutimet rreth pikave të rendit të ditës, **Agim Gashi** pyeti se a është fjala për Xhaminë e Madhe, të njohur tradicionalisht, apo xhaminë e re.

Dardan Sejdiu, nënkryetar i Komunës, tha se është fjala për xhaminë e re.

Agim Gashi u shpreh se kjo nuk mund të quhet xhamia e madhe, sepse e kemi emrin Xhami e Madhe, është emër tradicional dhe Prishtina identifikohet me Xhaminë e Madhe. **Halim Halimi**, kryesues i Komitetit, tha se nga Zyra komunale për komunitete dhe kthim na është sjellë **Plani komunal i veprimit për të zhvendosurit dhe zgjidhje të qëndrueshme**, që të futet si pikë e rendit të ditës. Është mirë ta shqyrtojmë sot dhe ta dërgojmë për Kuvend.

Njëzëri u miratua rendi i ditës, me propozimin që në rend dite të futet edhe pika "Plani komunal i veprimit për të zhvendosurit dhe zgjidhje të qëndrueshme".

Pika e parë

Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së tretë të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri u miratua ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes së tretë të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Pika e dytë

Plani komunal i veprimit për të zhvendosurit dhe zgjidhje të qëndrueshme.

Mustafë Neziri dha sqarime lidhur me Planin komunal të veprimit për të zhvendosurit dhe zgjidhje të qëndrueshme, duke cekur se ky Plan përmban rregullimin e procedurave të familjeve të cilat kërkojnë kthim në vendin e origjinës, të zhvendosur në Mal të Zi,

Maqedoni dhe Serbi. Në Plan janë përfshirë procedurat e kthimit, regjistrimit, ndërtimit etj. Lidhur me Planin e veprimit, Komuna është monitoruese, i monitoron të gjitha këto procedura dhe i propozon Ministrisë së Kthimit për zbatim, duke filluar nga ushqimi, ndërtimet, riparimet, që janë të rregulluara me rregullore që janë në kuadër të Ministrisë së Kthimit.

Dardan Sejdiu, nënkryetar i Komunës, bëri të ditur se për këtë Komuna nuk ka asnjë obligim financiar.

Agim Gashi pyeti se shërbimet tona komunale ose në nivel të Kosovës, Enti Statistikor a posedon të dhëna statistikore, në vija të trasha, për numrin e njerëzve që janë zhvendosur në këto tri shtete, e që një ditë pritet të kthehen. Nëse për këtë ka të dhëna, të na sillet një pasqyrë statistikore për mbledhjen e Kuvendit.

Mustafë Neziri u përgjigj, duke thënë se nuk kanë të dhëna të sakta dhe nuk mund të sigurojnë informata të sakta, sepse nuk janë të regjistruara kampet e Maqedonisë, Malit të Zi dhe Serbisë.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri u përkrah Plani komunal i veprimit për të zhvendosurit dhe zgjidhje të qëndrueshme dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim.

Pika e tretë

Propozimvendimi për dhënien e pronës së paluajtshme komunale në shfrytëzim afatgjatë ndërmarrjes publike komunale "Hortikultura".

Pika e katërt

Propozimvendimi për dhënien e pronës së paluajtshme komunale në shfrytëzim afatgjatë Fondacionit "Vier Pfoten".

Pika e pestë

Propozimvendimi për dhënien e pronës së paluajtshme komunale në shfrytëzim Kompanisë Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike (parcela 285-0).

Pika e gjashtë

Propozimvendimi për dhënien e pronës së paluajtshme komunale në shfrytëzim afatgjatë Ambasadës së Republikës së Shqipërisë.

Pika e tretë, e katërt, e pestë dhe e gjashtë u diskutuan në paketë.

Ardian Olluri tha se pikat: 3, 4, 5 dhe 6, faktikisht kanë kaluar në mbledhjen e fundit të Komitetit për Politikë dhe Financa, ndërsa në mbledhjen e Kuvendit tri pikat: pikat 3, pika 4 dhe pika 6 nuk janë votuar, për shkak se është konsideruar se jena brenda afatit 6-mujor, ndërsa pika e pestë nuk është votuar, edhe pse ka qenë afatshkurtër.

Tani jemi informuar se e kemi një interpretim nga Ministria, që thotë: "Dhënia në shfrytëzim për raste të veçanta, nuk i nënshtrohet kufizimit 6-mujor", që vlen për dhënien në shfrytëzim propozim projektit.

Halim Halimi, kryesues i Komitetit, tha se është e vërtetë që keni marrë një shkresë prej Ministrisë, e ata e kanë cituar ligjin, ku kanë cekur se për raste të veçanta mund të jepet, por cilat janë raste të veçanta, a janë të gjitha rastet të veçanta?!

Ardian Olluri tha se raste të veçanta janë kur shkon pa procedurë konkurruese.

Agim Gashi tha se në materialet që i kemi nuk thirremi fare në rregullore, ku në neni 20 e shpjegon çka nënkupton raste të veçanta dhe kur bëhen kërkesat dhe kush i bën për raste të veçanta. Mirëpo neni 20, pika 4 ka një paqartësi, mospërputhshmëri në mes të pikës 4 dhe pikës 3.3. Për të mos bërë shkelje dhe për të mos e kthyer vendimin mbrapa, është mirë që deri në mbledhjen e Kuvendit, t'i bëhet kërkesë Ministrisë se a kemi të drejt të procedojmë me këtë vendim për Ambasadën.

Ardian Olluri dha sqarime lidhur me këtë çështje.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri u përkrahën që pika e tretë, e katërt, e pestë dhe e gjashtë të dërgohen në Kuvend për shqyrtim.

Pika e shtatë

Propozimvendimi për bashkimin e blloqeve F-6, F-16, F-17 në kuadër të Planit rregullues urban "Prishtina e re - Perëndim".

Dardan Sejdiu, nënkryetar i Komunës, dha sqarime lidhur me këtë propozimvendim, duke cekur se është fjala për bashkimin e dy blloqeve në një bllok, në mënyrë që të mundësohet investimi në rritjen e qendrës tregtare "Albi Mall", i cili ka nënshkruar marrëveshjen me INDITEX që është ndër kompanitë më të mëdha në botë dhe me rritjen e kapaciteteve të saj krijohen rreth 400 vende të punës. Kanë bërë një kërkesë në Drejtorinë e Urbanizmit dhe drejtoria e ka shqyrtuar këtë çështje dhe ka ardhur me propozimin për bashkimin e këtyre dy blloqeve në një bllok.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri u përkrah **Propozimvendimi për bashkimin e blloqeve F-6, F-16, F-17 në kuadër të Planit rregullues urban "Prishtina e re - Perëndim"** dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim.

Pika e tetë

Propozimvendimi për ndërrimin e destinimit të bllokut "C-5", në kuadër të Planit rregullues urban "Medrese - Çamëri";

Kryesuesi konstatoi se njëzëri u përkrah **Propozimvendimi për ndërrimin e destinimit të bllokut "C-5", në kuadër të Planit rregullues urban "Medrese - Çamëri"** dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim.

Pika e nëntë

Propozimvendimi për ndërrimin e destinimit të parcelës 494-4, në kuadër të Planit rregullues urban "Prishtina e re - Perëndim".

Arben Vitia dha sqarime lidhur me këtë pikë, duke cekur se kanë qenë dy parcela të planifikuara sipas Planit rregullues më herët për ndërtimin e dy QMF-ve në Veternik, ku njëra ka qenë në lagjen "Qëndresa", mbrapa qendrës tregtare "Grand Store". Kemi pasur bisedime të vazhdueshme me pronarin e parcelës private për këmbim të pronës, mirëpo ai nuk e ka pranuar një gjë të tillë. Ndërsa në parcelën afër ndërmarrjes "Gorenje", është i ndërtuar një objekt shëndetësor privat, kështu që kemi gjetur një parcelë tjetër, përkatësisht brenda Planit zhvillimor urban, në pjesë të parcelës kadastrale 494-4, ZK Çagllavicë, në pronësi "pronë shoqërore, KK Prishtinë".

Kryesuesi konstatoi se njëzëri u përkrah Propozimvendimi për ndërrimin e destinimit të parcelës 494-4, në kuadër të Planit rregullues urban "Prishtina e re - Perëndim" dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim.

Pika e dhjetë

Propozimvendimi për dhënien e pronës së paluajtshme komunale në shfrytëzim Kompanisë Kosovare për Distribuid dhe Furnizim me Energji Elektrike (afatshkurtër).

Ardian Olluri dha sqarime lidhur me këtë pikë, njëkohësisht cekur se materiali nuk qenka komplet, mirëpo për mbledhjen e Kuvendit do të jetë i kompletuar.

Laura Zherka tha se materiali nuk është komplet, nuk e kemi numrin e ngastrave kadastrale etj.

Dardan Sejdiu, nënkryetar i Komunës, tha se këtu kemi vetëm bashkim blloqesh, nuk ka ngastra kadastrale, është vetëm vendim për bashkim blloqesh, por mundemi vetëm grafikisht me i paraqitur dy blloqet që po bashkohen në një.

Ardian Olluri tha se këtë propozimvendim në Kuvend do ta prezantojë Drejtoria e Planifikimit.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri u përkrah Propozimvendimi për dhënien e pronës së paluajtshme komunale në shfrytëzim Kompanisë Kosovare për Distribuid dhe Furnizim me Energji Elektrike (afatshkurtër) dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim.

Pika e njëmbëdhjetë

Propozimvendimi për dërgimin e Rregullores për të hyrat vetanake të institucioneve kulturore vartëse të Komunës së Prishtinës, në konsulta paraprake publike.

Besart Vllahinja dha sqarime lidhur me këtë pikë, duke cekur se rregullorja e prezantuar nga drejtoria ka të bëjë me destinimin e të hyrave të institucioneve kulturore vartëse të Komunës së Prishtinës. E konsiderojmë të rëndësishëm dërgimin në diskutim publikë dhe miratimin e kësaj Rregulloreje, me qëllim të destinimit dhe të hyrave të të gjitha institucioneve kulturore, si dhe përcaktimin e tarifave për kompensim. Fjala është për tri institucionet kulturore vartëse, për teatrin e qytetit të Prishtinës "Dodona" për Arkivin Komunal dhe bibliotekën komunale "Hivzi Sulejmani".

Lirak Çelaj pyeti se a e parasheh ligji nxjerrjen e një rregulloreje të tillë nga Komuna, apo ka të drejtë institucioni vetë të nxjerrë rregullore të vetën. Ai ceku se në nenin 2, pika 2.3 thuhet: "Dhuruesit e gjakut të lirohen nga pagesa", kjo mua nuk po më duket e arsyeshme, po ashtu pika 2.4, pse duhet të lirohen nga pagesa institucionet shtetërore qendrore dhe lokale etj. Unë e shohë të paarsyeshëm lirimin nga obligimi dhe kjo duhet të hiqet, të mos lejohet asnjë pa pagesë, përjashtim vetëm ndonjë rast i rrallë humanitar. **Halim Halimi, kryesues i Komitetit**, pyeti se në aspektin ligjor Komuna a mund të nxjerrë rregullore për të hyrat vetjake të institucioneve kulturore vartëse të Komunës së Prishtinës, apo mund vetë institucioni.

Ardian Olluri tha se në aspektin ligjor ende nuk kemi arritur ta shqyrtojmë këtë çështje, mirëpo në mbledhje të Kuvendit do të japim përgjigje.

Besart Vllahinja tha se kjo është një rregullore e bazuar në Rregulloren për institucionet arsimore. Sa i përket tarifave të përcaktuara, ka vend për t'u diskutuar edhe në diskutim publik, dhe mund të plotësohet kjo rregullore.

Mirlinda Sopi tha se në titull e kemi "Propozimvendimi për dërgimin e Rregullores për të hyrat vetanake ...", kujt po ia dërgojmë, dërgim në diskutim publik? Pra po i mungon një fjali këtu në titull në rendin e ditës. Kjo rregullore do të dalë në diskutim publik dhe do të begatohet me propozime dhe vlerësime nga ekspertë të fushave të caktuara. Për ne është në rregull dhe pajtohem që kjo Rregullore të përcillet në Kuvend.

Agim Gashi shprehu mendimin se kjo Rregullore është e afërt me Rregulloren e arsimit, mirëpo te arsimi ka qenë problem se institucionet e edukativo - arsimore nuk kanë pasur konto të hapur dhe nuk kanë mundur ta bëjnë qarkullimin e mjeteve përmes bankës, që as sot nuk kanë, me përjashtim të shkollave profesionale. Institucionet e kulturës nuk e di a i kanë, por Ligji mbi financat i pengon këto gjëra, nuk i lejon.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri u përkrah Propozimvendimi për dërgimin e Rregullores për të hyrat vetanake të institucioneve kulturore vartëse të Komunës së Prishtinës në konsulta paraprake publike dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim.

Pika e dymbëdhjetë

Propozimvendimi për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme komunale - fushat e tenisit.

Halim Halimi, kryesues, tha se nuk kemi material për këtë pikë, andaj e tërheqim prej rendit të ditës.

Pika e trembëdhjetë

Raporti për sigurinë në shkolla.

Halim Halimi, kryesues i Komitetit, tha se ky raport më shumë është teorik, nuk është konkret se si e kemi gjendjen e sigurisë në shkollat e Prishtinës.

Dardan Sejdiu, nënkryetar i Komunës, tha se në Kuvend drejtoresha e Drejtorisë së Arsimit do të na raportojë për sigurinë në shkolla.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri u përkrah Raporti për sigurinë në shkolla dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim.

Pika e katërmbëdhjetë

Diskutim për projektin e xhamisë së madhe në Prishtinë.

Dardan Sejdiu, nënkryetar i Komunës, dha sqarime, duke cekur se kryetari ka kërkuar që të diskutohet në Kuvendin e Komunës projekti i xhamisë, që është paraparë të ndërtohet pranë objektit të Postës. Kjo do të diskutohet, të shpjegohet para asamblistëve se çka po kërkohet dhe si me vepruar më tutje. Kryetari ka pasur disa takime me myftiun, z. Tërnavë, dhe mendojmë se është mirë që secili asamblist i Kuvendit të Komunës së Prishtinës të ketë informacionet lidhur me ato takime, në mënyrë që diskutimi të jetë sa më përmbajtësor dhe vendimi të jetë sa më gjithëpërfshirës.

Halim Halimi, kryesues i Komitetit, u shpreh se këtë po e kuptoj vetëm si njoftim i anëtarëve të Kuvendit rreth ndërtimit të xhamisë në lokacionin afër Postës.

Lirak Çelaj tha se nuk po e kuptoj si njoftim, sepse nënkryetari tha diskutim, kështu që ka dallim njoftimi nga diskutimin.

Dardan Sejdiu, nënkryetar i Komunës, tha se nuk po marrim vendim, është vetëm njoftim, që duhet të dijë secili asamblist i Kuvendit se është një objekt, çka po kërkohet dhe si po mendohet të veprohet tutje.

Të ndryshme

Kryesuesi propozoi që mbledhja e radhës së Kuvendit të mbahet më 25.07.2017.

Mirlinda Sopi tha se dy mbledhje më parë janë votuar kompanitë publike dhe aksionarët dhe unë kam kërkuar nga Zyra ligjore, z. Olluri, një interpretim me shkrim për mënyrën e votimit të anëtarëve të kompanisë "Trafiku Urban". Këtë po e kërkoj prapë nga z. Olluri, që për seancën e radhës të na sillet me shkrim interpretimi.

Ardian Olluri tha se do ta shqyrtojë këtë çështje.

Halim Halimi, kryesues i Komitetit, bëri të ditur se në Kuvend do ta bëjmë një njoftim për një vendim, për të cilin kemi konstatuar (unë dhe Zyra ligjore kemi menduar se nuk ka kaluar në Kuvend në bazë të votave), por kemi marrë interpretimin prej Ministrisë së Pushtetit Lokal se kjo ka kaluar.

Mbledhja përfundoi në orën 16:00.

Procesmbajtësja
Shyhrete Islami

Kryesuesi i Komitetit
Halim Halimi, jur. i dipl.

